

## A E DINI SE:

### Çfarë mbështetje ofron bashkia/struktura përgjegjëse lokale për shërbimin e kujdestarisë?

Masa e financimit për familjen kujdestare, për shpenzimet ushqimore për një fëmijë të vendosur në kujdestari, është 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj, ndërsa për shpenzimet e ushqimit të një fëmije me aftësi të kufizuara është 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

Masa e financimit për familjen kujdestare, për një fëmijë të vendosur në kujdestari, është si vijon:

- shpenzime për veshmbathje: 10 000 (dhjetë mijë) lekë në vit;
- shpenzime për shkollimin: 5 000 (pesë mijë) lekë në vit; dhe
- shpenzime të tjera: 10 000 (dhjetë mijë) lekë në vit.

Pagesa e familjes kujdestare bëhet një herë në muaj, pranë njësisë administrative, ku ka vendbanimin e përhershëm familja kujdestare.

Ne kemi nevojë për kujdestarë për fëmijë të të gjitha moshave.

Nëse ju ose dikush që ju njihni dëshiron të mësoj më shumë se si të bëhet një prind kujdestarë, lutemi për më shumë informacion ju ftojme të drejtoheni në:



Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes/ACFD  
Rr. Mine Peza, P.194, Ap.18, shk.3, Tiranë  
Person kontakt: Eranda Ndregjoni  
0693181508  
www.acfd.org.al  
Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes/ACFD  
Bëhu familja ime!



SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqiperi  
Rr.Hermann Gmeiner, Nr.5 Sauk, Tiranë  
+355 4 453 6901  
info@soskd.org.al  
www.soskd.org.al  
SOS Fshatrat E Femijsve Shqiperi



Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)  
Bulevardi "Bajram Curri", Pallatet Agimi, Shk. 18, Ap.322, Tiranë, Shqipëri  
+355 4 2253113  
tlas@tlas.org



Bashkia Tiranë  
Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri  
0800 0888  
info@tirana.al

Kjo fletëpalosje është prodhuar në kuadër të projektit "Zhvillimi i OSHC-ve për Familjet Kujdestare në Shqipëri" i implementuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqiperi dhe TLAS, i financuar nga Bashkimi Evropian. Përbajtja e këtij publikimi ose pikëpamjet e autorit jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të Bashkimit Evropian.

**Njësia Administrative Nr.2**  
Person kontakt: Eva Dako  
069 83 46 948

**Njësia Administrative Nr. 4**  
Person kontakt: Redona Rustemaj  
069 62 12 047

**Njësia Administrative Nr.11**  
Person kontakt: Zineida Llanaj  
069 40 18 680



# BËHU FAMILJA IME!

## Asnjë fëmijë nuk duhet të rritet vetëm.

### Të gjithë fëmijët duhet të kenë mundësinë të jetojnë thjesht jetën, si një fëmijë.



"Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian"

Ky projekt zhvillohet në kuadër të projektit "Zhvillimi i OSHC-ve për Familjet Kujdestare në Shqipëri" i implementuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqiperi dhe TLAS, i financuar nga Bashkimi Evropian.

▶ **A e dini se edhe një familje kujdestare mund të kujdeset shumë për një fëmijë dhe t'ja sigurojë atë me mbrojtje dhe dashuri?**

▶ **A e dini si?**

▶ **Dëshiron të bëhesh familje kujdestare?**

## A E DINI SE:

### Çfarë do të thotë kujdestari?

Kujdestari do të thotë të kujdesesh dhe të ndash shtëpinë dhe jetën tënde familjare me fëmijë që nuk kanë mundësi të jetojnë me familjen e tyre biologjike për arsye të ndryshme. Fëmijët vendosen me një familje kujdestare kur prindërit e tyre e kanë të pamundur të kujdesen për ata. Fëmijët që shkojnë në kujdestari kanë nevojë të jenë pjesë e familjes dhe të kenë kujdesin e të rriturve, të cilët duhet të përpiqen t'i kuptojnë ata dhe t'i bëjnë të ndihen të sigurt.

### Çfarë do të thotë familje kujdestare?

Familja kujdestare është një familje alternative (pra e ndryshme nga familja biologjike) e vendosur nga gjykata, për t'i ofruar fëmijës një mjedis familjar, kushte për mirëritje, përkujdesje fizike dhe mbështetje emocionale.

### Cilët janë fëmijët që kanë nevojë për një familje kujdestare?

Kujdestaria, është një shërbim social alternativ me baza komunitare, ku fëmijës që ka nevojë i ofrohet një familje e re, për shkak të problemeve ekonomike, shëndetësore dhe sociale të familjes së tij/saj apo të braktisjes së fëmijës të lindur jashtë martese. Vendosja e tyre në familje kujdestare është e përshtatshme për aq kohë sa familja biologjike e fëmijës të ketë mundësi dhe aftësi për t'u kujdesur për fëmijën e tyre.

### Cilat janë kriteret për t'u bërë familje kujdestare?

Kriteret për të qenë familje kujdestare janë të përcaktuara në VKM nr. 149, datë 13.03.2018 "Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare". Kriteret janë:

- Të ketë shfaqur interesin për të ofruar shërbimin e përkujdesjes alternative;
- Anëtarët e familjes të jenë të motivuar për të qenë familje kujdestare;
- Anëtarët e familjes të mos kenë qenë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë nga gjykata;
- Prindërit kujdestarë të kenë aftësi për të kryer detyrën e kujdestarit;
- Prindërit kujdestarë dhe të gjithë anëtarët e familjes të vërtetojnë me raport mjekësor nga komisioni mjeko-ligjor që janë të aftë për të ofruar këtë shërbim dhe se nuk mbartin sëmundje të transmetueshme;
- Të strehojnë dhe të garantojnë mjedis familjar të sigurt për fëmijën;
- Anëtarët e familjes të mos kenë qëndrime diskriminuese ndaj fëmijëve, fëmijëve me aftësi të kufizuara apo fëmijëve që i përkasin një minoriteti të caktuar;
- Të respektojnë ushtrimin e besimit fetar të fëmijës/fëmijëve apo të gjitha gjendjet e fëmijës sipas njërit apo disa prej shkaqeve të parashikuara në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi;
- Prindërit kujdestarë të kenë kuptim të qartë dhe të jenë të gatshëm të zbatojnë parimin e veprimit, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës;
- Prindërit kujdestarë të jenë të gatshëm për të bashkëpunuar me familjen biologjike të fëmijës dhe me strukturën përgjegjëse për shërbimin e kujdesit alternativ;
- Prindërit kujdestarë nuk kanë humbur, nuk u është hequr përgjegjësia prindërore ose nuk u është hequr detyra e kujdestarit në një rast tjetër;
- Prindërit kujdestarë të jenë nën moshën 65 vjeç;
- Prindërit kujdestarë të ushtrojnë përgjegjësinë prindërore në jo më shumë se tre fëmijë.

### Tipe të ndryshme të kujdestarisë

- Prindërit kujdestarë afatshkurtër ose afatgjatë
- Kujdesen për disa javë, muaj ose vite
- Ose derisa fëmija mbush moshën 18 vjeç



### Shërbimet mbështetëse

- Ofrimi i një trajnimi të vazhdueshëm
- Pagesë mujore për të mbuluar shpenzimet e kujdesit për fëmijën
- Kjo pagesë nuk ndikon në pagesat e tjera të Përkujdesjes Shoqërore
- Ndërhyrja dhe mbështetja e Punonjësit Social për fëmijën dhe familjen kujdestare
- Mbështetje të tjera të nevojshme mund të ofrohen nga organizata Fshati SOS, Shërbime Sociale Bethany, TLAS etj.

### Ku duhet të drejtohem për t'u bërë familje kujdestare?

#### Bashkia

Bashkia është përgjegjëse për evidentimin e familjeve të gatshme për të qenë familje kujdestare në territorin e bashkisë/njësisë administrative përkatëse, në zbatim të Kodit të Familjes.

#### Kërkesa

Çdo familje e interesuar duhet të shpreh dëshirën dhe vullnetin e plotë, duke paraqitur një kërkesë pranë strukturës përgjegjëse, sipas formularit që ju jepet nga punonjësi social përgjegjës.

#### Punonjësi Social Përgjegjës

Punonjësi social përgjegjës bën vlerësimin paraprak të familjeve të interesuara në bazë të kriterëve të vlerësimit.